



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 939/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rustem Thaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelin e paraqitur nga Agim Behluli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.939/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Agim Behluli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimin 1818E/02D në fshatin Orllan.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021, nga Agim Behluli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga Subjekti Politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me të cilin kërkon që të bëhet rinumërimi i votave në VV 1818E/02D

Si prove në apel parashtruesi ka bashkangjitur 1 kopje të letërnjoftimit si dhe 1 kopje të FRP-ve dhe FRK-ve.

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të subjektit politik LDK gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi Formularin e bashkangjitur në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se i njëjtit nuk është bazë e mjaftueshme për të kolauduar se në këtë VV ka pasur parregullsi, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i paraqitur nga Agim Behluli, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Podujevës, nga Subjekti Politik LDK, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për subjektin politik LDK, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar të gjitha fletëvotimet në vendvotimin e lartcekur, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin, e votave në VV në fjalë sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 939/2021 më datën 07.11.2021

Kryesuesi i Panelit

Adnan Konushovci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.